

Vendim nr. 46 datë 28.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 28.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ABEDIN DERVISHI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 126, datë 26.07.2022; nr. 104, datë 21.09.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 18, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasja Sh. D. i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesëpadi me objekt njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit të datës 17.12.2021 të Gjykatës së Lartë Stamford/Norwalk, shteti Konektikat, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilin është zgjidhur martesa midis saj dhe kërkuarit Abedin Dervishi, si dhe janë urdhëruar dhe rregulluar pasojat civile pasurore nga zgjidhja e kësaj martese.

2. Me vendimin nr. 126, datë 26.07.2022, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës. Njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit të gjykatës së huaj, vendimit datë 17.12.2021, të Gjykatës së Lartë Stamford/Norwalk, shteti Konektikat, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në çështjen FST FA 21-50242065-S, me të cilin është zgjidhur martesë ligjore midis Sh. D dhe personit të tretë Abedin Dervishi, si dhe është disponuar për pasojat civile nga zgjidhja e saj. Vendimi i arsyetuar i njoftohet palëve. Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të tij.”.*

3. Pas dhënies së këtij vendimi, shtetasja Sh. D. ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e gjykatës së huaj të njohur dhe dhënë fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë me vendimin nr. 126, datë 26.07.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rregullimin e pasojave civile nga zgjidhja e martesës.

4. Me vendimin nr. 104, datë 21.09.2022, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e gjykatës së huaj, të vendimit datë 17.12.2021, të Gjykatës së Lartë Stamford/Norwalk, shteti Konektikat, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në çështjen FST FA 21-50242065-S, i njohur dhe dhënë fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë me vendimin nr. 126, datë 26.07.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.”.*

5. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 22.12.2022, për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit, kërkesë e cila është plotësuar në datën 23.01.2023.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, duke pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt në aspektet e mëposhtme:

6.1. Gjykata e Apelit Tiranë ka njohur një vendim i cili ende nuk ka marrë formë të prerë, pasi ai është apeluar nga kërkuesi dhe është në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Stamford/Norwalk (SHBA), e cila ka caktuar si datë të zhvillimit të seancës datën 17.01.2023. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Stamford/Norwalk është përkthyer gabim në pjesën që konsiderohet përfundimtar, duke sjellë pasoja të pariparueshme për kërkuesin.

6.2. Është cenuar neni 15 i Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, si dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik, pasi kërkuesit i është mohuar e drejta për të jetuar me të ardhurat financiare si ish-ushtarak.

- 6.3. Është cenuar parimi i barazisë para ligjit, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, pasi shtetasja Sh. D. ka kryer mashtrime para Gjykatës së Apelit Tiranë.

III Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, për rrjedhojë, si bartës i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, të pretenduar të cenuar, provon interesin e tij të drejtpërdrejtë.

10. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuari përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

11. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor.

Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar vendimin nr. 126, datë 26.07.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë me anë të të cilit është bërë njohja e vendimit të gjykatës së huaj. Nga përmbajtja e ankimit kushtetues dhe verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se kërkuuesi nuk ka ushtruar rekurs kundër këtij vendimi, por i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese. Në lidhje me mungesën e paraqitjes së këtij mjeti juridik kërkuuesi nuk ka dhënë asnjë shpjegim se pse nuk ka zgjedhur që ta ankimojë çështjen në Gjykatën e Lartë.

13. Gjithashtu, kërkuuesi ka kundërshtuar edhe vendimin nr. 104, datë 21.09.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë, në të cilin është vendosur lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për vendimin e gjykatës së huaj të njohur dhe dhënë fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë me vendimin nr. 126, datë 26.07.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Pavarësisht se në dispozitivin e këtij vendimi, kjo gjykatë është shprehur se kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim, nga materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues konstatohet se në datën 06.12.2022 kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë duke kërkuar pezullimin e veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimi nr. 126, datë 26.07.2022 i kësaj gjykate, për të cilin ende nuk rezulton të ketë një vendimmarrje.

14. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkuuesi nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës, për rrjedhojë kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.